

Rekomandim CM/Rec(2022)2 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi përgjegjshmërinë demokratike të përfaqësuesve të zgjedhur dhe organeve të zgjedhura në nivel lokal dhe rajonal

*(Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 9 shkurt 2022
në mbledhjen e 1424-të të zëvendësministrave)*

Komiteti i Ministrave, sipas kushteve të nenit 15b të Statutit të Këshillit të Europës,

Duke pasur parasysh që synimi i Këshillit të Europës është arritja e unitetit më të madh ndërmjet anëtarëve të tij për qëllim të ruajtjes dhe realizimit të idealeve dhe parimeve që janë trashëgimi e tyre e përbashkët dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe social të tyre;

Duke pasur parasysh dëshirën në rritje të qytetarëve për të thënë fjalën e tyre në menaxhimin dhe shqyrtimin e çështjeve publike në nivelet territoriale që janë më afër tyre, dhe që pjesëmarrja aktive e qytetarëve në menaxhimin e çështjeve publike lokale dhe rajonale, *inter alia* duke marrë përsipër funksione zgjedhore është një parakusht për një demokraci efektive;

Duke pasur parasysh përfitimet e shumta që sjell një sistem dhe kultura e zhvilluar e llogaridhënies së përfaqësuesve të zgjedhur dhe organeve të zgjedhura në nivel lokal dhe rajonal, veçanërisht në lidhje me promovimin e qeverisjes së mirë, demokracisë, standardeve të larta të etikës publike, besimit në institucionet publike dhe mjedisit të qëndrueshëm socio-ekonomik;

Duke pasur parasysh se, në përgjithësi, transparencja në lidhje me veprimet e përfaqësuesve dhe organeve të zgjedhura dhe organeve të ndryshme nën kompetencën e tyre, dhe cilësia e informacionit dhe aksesit i lehtë në informacionin e mbajtur nga autoritetet publike janë veçori tepër të rëndësishme të një kuadri llogaridhënieje;

Duke pasur parasysh që qartësia e legjislacionit në lidhje me vetëqeverisjen lokale dhe rajonale, veçanërisht në përcaktimin e përgjegjësi, duke përfshirë pasojat e menaxhimit joadekuat, është kusht thelbësor për qeverisjen e mirë në përputhje me sundimin e ligjit dhe të drejtat themelore, si edhe për sigurinë e atyre që japin llogari;

Duke pasur parasysh gjithashtu se, mes tendencave të fundit, përdorimi i formave të ndryshme të dhunës kundër përfaqësuesve të zgjedhur është bërë një burim shqetësimi në rritje në shumë shtete anëtare dhe se kjo mund të pengojë kandidaturat dhe kështu të ndikojë në rinovimin e nevojshëm të udhëheqjes politike, si dhe të ketë ndikim negativ në kapacitetin për iniciativë dhe efektivitetin e veprimit publik;

Duke pasur parasysh se përvoja e shumë shteteve anëtare tregon se është e nevojshme të organizohen sisteme të llogaridhënies në mënyrë të tillë që të garantojnë, në bazë të Kartës Europiane të Vetëqeverisjes Lokale (ETS Nr. 122), si efektivitetin e autoriteteve lokale ashtu edhe ruajtjen e “një shkallë të gjerë autonomie në lidhje me përgjegjësitë e tyre, mënyrat dhe mjetet me të cilat ato përgjegjësi ushtrohen dhe burimet e nevojshme për përmbushjen e tyre”;

Duke pasur parasysh:

- Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (ETS nr.5);
- Kartën Europiane të Vetëqeverisjes Lokale (ETS Nr. 122) dhe Protokollin e saj Shtesë mbi të drejtën për të marrë pjesë në punët e autoriteteve lokale (CETS nr. 207);
- instrumentet e tjera ligjore të Këshillit të Europës, të cilat përmbajnë dispozita përkatëse për çështjen e llogaridhënies publike, siç është Konventa për Njohjen me Dokumentet Zyrtare (CETS Nr. 205), Rekomandimi Rec(99)8 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare mbi përgjegjësinë financiare të përfaqësuesve të zgjedhur vendorë për veprime ose mosveprime gjatë kryerjes së detyrave të tyre, Rekomandimi CM/Rec(2014)7 për mbrojtjen e sinjalizuesve, Rekomandimi CM/Rec(2018)4 për pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën publike në nivel lokal dhe Rekomandimi CM/Rec(2019)3 për mbikëqyrjen e aktiviteteve të autoriteteve vendore;
- Deklaratën e Valencias dhe Strategjinë për Inovacionin dhe Qeverisjen e Mirë në Nivel Lokal, duke përfshirë 12 Parimet e Qeverisjes së Mirë Demokratike, të miratuara në sesionin e 15-të të Konferencës së Ministrave Europianë të Këshillit të Europës përgjegjës për Qeverisjen Lokale dhe Rajonale (15-16 tetor 2007). dokumenti CM(2008)14), konkretisht Parimi 12 (llogaridhënia);
- punën e Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Europës, në veçanti Rekomandimin 423 (2018) “Konfliktet e interesit në nivel lokal dhe rajonal”, Rekomandimin 424 (2018) “Transparenca dhe qeverisja e hapur”, Rekomandimin 395 (2017).) “Problemet e përsëritura të identifikuar në vlerësimet pas misioneve monitoruese dhe vëzhguese të zgjedhjeve të Kongresit (periudha e referimit 2010-2016)”, raportin e tij me titull “Një koment bashkëkohor i Kongresit mbi relacionin shpjegues të Kartës Europiane të Vetëqeverisjes Lokale” (dhjetor 2020) dhe Rekomandimin 459 (2021) “Zhvillimi i referendumëve në nivel vendor”;
- punën e Komisionit Europian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), duke përfshirë raportin e tij mbi tërheqjen e kryetarëve të bashkive dhe përfaqësuesve të zgjedhur vendorë (dokumenti CDL-AD(2019)011rev, qershor 2019);
- çështjet e përsëritura të identifikuar në punën monitoruese të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO);
- Objektivat e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm (OZHQ), në veçanti Objektivi nr. 16, “Paqja, drejtësia dhe institucionet e forta”,

Rekomandon që qeveritë e shteteve anëtare duke pasur parasysh përkufizimet, parimet dhe udhëzimin e dhënë në shtojcë, të ndërmarrin detyrat e përcaktuara në paragrafët 1 deri në 5 më poshtë ose t'u besojnë këto detyra autoriteteve kompetente publike, duke pasur parasysh parashikimet e tyre përkatëse kushtetuese ose legjislative.

1. të krijojnë dhe të mbajnë një kuadër llogaridhënieje për përfaqësuesit e zgjedhur dhe organet e zgjedhura në nivel lokal dhe rajonal, duke përfshirë legjislacionin, institucionet, procedurat, praktikat dhe normat e duhura të sjelljes të cilat së bashku krijojnë kushtet dhe kulturën me anë të së cilës:
 - a. vendimmarrësit marrin përgjegjësi për vendimet e tyre;
 - b. këto vendime raportohen, shpjegohen, shqyrtohen dhe, sipas rastit, vihen në diskutim ose sanksionohen; dhe
 - c. ekzistojnë mjete juridike efektive dhe proporcionale për vendimet ose mosveprimet e papërshtatshme dhe çdo veprim ose mosveprim që rezulton;
2. të sigurohen që parashikimet brenda këtij kuadri të funksionojnë në mënyrë plotësuese me sistemet gjyqësore, politike dhe administrative të shtetit anëtar, duke përfshirë ato sisteme të krijuara për përfaqësuesit e zgjedhur dhe organet e zgjedhura në nivel kombëtar;
3. të përfshijnë përfaqësuesit e zgjedhur vendorë dhe rajonalë në konsideratat për reformat që do të ndërmerren në kuadrin e llogaridhënies dhe procedurat për zbatimin e tyre;

4. të vlerësojnë periodikisht masat e miratuara dhe të ndërmarrin, nëse është e nevojshme, reforma legjislative për të përmirësuar efektivitetin e mekanizmave të llogaridhënies siç përcaktohet në kuadër, si edhe konsistencën e zbatimit të tyre. Në këtë mënyrë, shtetet anëtare duhet të marrin parasysh rekomandimet që rezultojnë nga aktivitetet e monitorimit dhe vëzhgimit të kryera nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Europës për zbatimin e Kartës Europiane të Vetëqeverisjes Lokale;
5. të përkthejnë këtë rekomandim në gjuhën(t) zyrtare të vendit dhe ta shpërndajnë dhe promovojnë në mënyrë aktive tek autoritetet lokale dhe rajonale, shoqatat e tyre dhe palët e tjera të interesuara.
6. gjatë marrjes së masave zbatuese, të marrin parasysh së bashku këtë rekomandim dhe Rekomandimin Rec(99)8 e Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi përgjegjësinë financiare të përfaqësuesve të zgjedhur vendorë për veprime ose mosveprime gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

Shtojcë

Përkufizime, parime dhe udhëzime në lidhje me përgjegjshmërinë e përfaqësuesve të zgjedhur dhe organeve të zgjedhura në nivel lokal dhe rajonal

1. Përkufizime

1.1 Për qëllimet e këtij rekomandimi:

- a. "Përfaqësues të zgjedhur në nivel lokal dhe rajonal" (të referuar si "përfaqësues") i referohet atyre që zgjidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi nga popullsia e një njësie gjeografike për t'i përfaqësuar ata. Këtu përfshihen ata të përzgjedhur nga përfaqësues të tjerë të zgjedhur për të mbajtur një detyrë në një autoritet vendor ose rajonal dhe/ose organ të tij ekzekutiv (përfshirë një këshilltar, kryetar bashkie, drejtues, dekan, etj.);
- b. "organet e zgjedhura në nivel lokal dhe rajonal" (të referuara si "organe") janë organe të përbëra ekskluzivisht ose kryesisht nga përfaqësues të zgjedhur, duke përfshirë asamblenë e një autoriteti dhe/ose organin e tij ekzekutiv dhe çdo nënkomision të atij asambleje/organi ekzekutiv, (përfshirë këshillat, bashkitë dhe qarqet bashkiake, njësitë territoriale, komunat, rajonet, krahinat, etj.);
- c. "i përgjegjshëm" do të thotë të jesh i gatshëm dhe i aftë për të marrë përgjegjësi për vendimet, për të raportuar dhe shpjeguar ato vendime dhe për t'u përgatitur për t'u ekzaminuar në lidhje me ato vendime, si dhe për të pranuar çdo pasojë ose sanksion proporcional ndaj vendimeve ose mosveprimeve të papërshtatshme;
- d. "llogaridhënie", është kushti për të qenë i përgjegjshëm;
- e. një "kuadër llogaridhënieje" përfshin, sipas rastit, legjislacionin, institucionet, procedurat, praktikat dhe normat e sjelljes, në mënyrë që qytetarët të kenë besim në llogaridhënien e përfaqësuesve dhe organeve të tyre në nivel lokal dhe rajonal;
- f. "përgjegjësi" nënkupton ato funksione, kompetenca, çështje, veprime dhe detyra për të cilat përfaqësuesit dhe organet duhet të jenë të përgjegjshëm.

2. Parimet e llogaridhënies

- 2.1 Llogaridhënia përfshin një sërë marrëdhëniesh të ndryshme ndërmjet palëve dhe një transferim të pushteteve, funksioneve dhe përgjegjësi nga njëra palë në tjetrën.
- 2.2 Si parim bazë, përfaqësuesit dhe organet japin llogari ndaj atyre që u kanë dhënë një pozitë autoriteti ose pushteti nëpërmjet zgjedhjes së drejtpërdrejtë. Po kështu, ata të cilëve u është dhënë një pozitë pushteti ose autoriteti për të kryer funksione ekzekutive ose mbikëqyrëse, nëpërmjet caktimit ose emërimit brenda një organi të zgjedhur, japin llogari para atyre që ua kanë dhënë atë pozitë.
- 2.3 Prandaj, përfaqësuesve dhe organeve u kërkohet të japin llogari për veprimet e tyre para qytetarëve dhe votuesve në lidhje me fushën e përgjegjësi të detyrës së tyre. Atyre do t'u kërkohet gjithashtu të japin llogari ndaj të tjerëve të përfshirë në çdo sistem formal auditimi ose kontrolli. Përveç kësaj, mund të ketë zyrtarë ose organe që janë përgjegjës për sjelljen e një përfaqësuesi ose organi, si dhe një sërë grupesh të palëve të interesuara që do të preken në një mënyrë ose në një tjetër nga veprimet e përfaqësuesve dhe organeve.
- 2.4 Llogaridhënia është personale dhe nuk mund të delegohet. Kur përgjegjësitë i janë deleguar një personi ose organi tjetër, përfaqësuesit dhe organet mbeten përgjegjëse për ato çështje.
- 2.5 Disa aspekte të këtyre marrëdhënieve të llogaridhënies do të institucionalizohen ose mishërohen brenda mekanizmave organizativë ose politikë: llogaridhënia politike për sjelljen e përgjithshme të politikave (para votuesve ose një organi tjetër); përgjegjësia ligjore/gjyqësore për aktet që sjellin një padi civile ose përgjigje ligjore (para gjykatave); dhe llogaridhënia menaxheriale për menaxhimin e përgjithshëm administrativ dhe financiar të burimeve dhe procedurave (nëpërmjet kontrollit të menaxhimit, kontrollit gjyqësor, auditimit të jashtëm, etj.).

2.6 Për të nxitur sjelljen e përgjegjshme, është thelbësore të sigurohet hapja dhe transparenca e veprimeve të përfaqësuesve dhe organeve, si dhe atyre të administratave dhe subjekteve nën përgjegjësinë e tyre, duke lejuar që veprimet të vendosen në qendër të vëmendjes së publikut dhe t'i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm. Prandaj, hapja dhe transparenca duhet të promovohen në mënyrë aktive me të gjitha mjetet.

2.7 Llogaridhënia efektive do të mbështetet gjithashtu në një sërë elementësh jashtë institucioneve dhe sistemeve formale, të tilla si një shoqëri civile aktive, qytetarë të informuar dhe të arsimuar politikisht dhe një shtyp dhe media e lirë dhe e pavarur që raporton mbi funksionimin e sistemit politik.

3. Udhëzime mbi kuadrin efektiv të llogaridhënies për përfaqësuesit e zgjedhur dhe organet e zgjedhura në nivel lokal dhe rajonal

3.1 Parimi i llogaridhënies mund të bëhet realitet praktik duke krijuar një kuadër llogaridhënieje që përfshin rregullore, rregulla, norma, institucione dhe praktika, të cilat duhet të promovohen përmes trajnimeve dhe nismave ndërgjegjëse. Një kuadër efektiv i llogaridhënies do të identifikojë elementët e mëposhtëm të marrëdhënieve të llogaridhënies.

i. Kush është përgjegjës dhe për çfarë jep llogari

3.2 Për të gjithë përfaqësuesit dhe organet, kuadri i llogaridhënies duhet të identifikojë dhe dokumentojë qartë çështjet për të cilat ata janë përgjegjës dhe shkallën në të cilën ata japin llogari ligjërisht dhe financiarisht.

3.3 Përfaqësuesit dhe organet që u janë besuar funksionet kolegjiale, këshilluese dhe kontrolluese (zakonisht asamblatë lokale/rajonale) duhet të japin llogari për mënyrën se si i kryejnë këto detyra. Përfaqësuesit dhe organet që u janë besuar detyrat ekzekutive dhe menaxheriale (zakonisht funksionet e qeverisjes vendore/rajonale, duke përfshirë kryetarët e bashkive) duhet të japin llogari për mënyrën në të cilën ofrohen shërbimet publike, duke përfshirë zbatimin e politikave dhe objektivave për të cilat është rënë dakord me organin këshillues.

3.4 Kur është e mundur, duhet të reduktohet numri i ligjeve, rregulloreve dhe rregullave të tjera që përfaqësuesit dhe organet duhet të zbatojnë, veçanërisht dekretet dhe qarkoret e ministrave; legjislacioni në fuqi në sferat kryesore të veprimtarisë së përfaqësuesve dhe organeve duhet të paraqitet si legjislacion i konsoliduar.

ii. Si do të japin llogari dhe kujt duhet t'i japin llogari

3.5 Rëndësi e madhe duhet t'i kushtohet aftësisht të qytetarëve dhe shoqërisë civile për të shprehur opinione, për të dhënë komente mbi politikën, për të formuluar sugjerime dhe për të shprehur kritika ose shqetësime. Kjo mund të përfshijë referendume, nisma popullore dhe forma të ndryshme pjesëmarrjeje dhe konsultimi. Për krijimin e këtyre masave, mund të merret frymëzimi nga Protokollu Shtesë i Kartës Europiane të Vetëqeverisjes Lokale mbi të drejtën për të marrë pjesë në punët e një autoriteti lokal (CETS Nr. 207). Vëmendje dhe konsideratë e veçantë duhet t'u kushtohet atyre që mund të kenë pengesa në pjesëmarrje për t'u mundësuar shprehjen e mendimit në çështjet që i prekin.

3.6 Diskutimet e kuvendeve lokale dhe rajonale duhet të jenë publike; axhenda dhe dokumentet e rëndësishme të diskutuara në takime duhet të vihen në dispozicion në kohën e duhur. Ligji duhet të parashikojë rrethana të kufizuara në të cilat takimet mund të mbahen të mbyllura dhe përfaqësuesit dhe organet duhet të jenë të përgatitur për të raportuar mbi vendimet e marra në këto mbledhje.

3.7 I gjithë informacioni i dhënë për qëllimin e kontrollit duhet të vihet në dispozicion në një format që është i aksesueshëm dhe i rëndësishëm për ata për të cilët synohet. Informacioni që bëhet publik duhet të jetë objektiv dhe i cilësisë së lartë, me qëllim që t'u mundësojë qytetarëve formimin e opinioneve të tyre për veprimet e përfaqësuesve dhe organeve. Kur shfrytëzohet potenciali i teknologjisë së re të informacionit, duhet t'i kushtohet vëmendje e kujdesshme për të siguruar aksesin për grupet që hasin pengesa me qasjen e informacionit në internet.

- 3.8 Kuadri ligjor duhet të sigurojë një sistem gjithëpërfshirës të mbajtjes, ruajtjes, klasifikimit dhe arkivimit, duke përfshirë periudhat e ruajtjes, në lidhje me dokumentet zyrtare dhe të tjera që kanë të bëjnë me veprimtarinë dhe përgjegjësitë e përfaqësuesve dhe organeve, duke përfshirë veprimtarinë e organeve nën përgjegjësinë e tyre. Periudhat e mbajtjes duhet të jenë në raport me afatet dhe parashkrimin e parashikuar për proceset gjyqësore. Duhet të vendosen gjithashtu politika për të trajtuar kërkesat specifike për informacion të mbajtur nga autoritetet lokale dhe rajonale. Frymëzimi mund të merret nga Konventa e Këshillit të Europës për Njohjen me Dokumentet Zyrtare (CETS Nr. 205) dhe Protokolli Shtesë i Kartës Europiane të Vetëqeverisjes Lokale mbi të drejtën për të marrë pjesë në punët e autoriteteve lokale (CETS nr. 207).
- 3.9 Procesi i kontrollit duhet të udhëhiqet nga rregulla dhe rregullore adekuate të cilat përcaktojnë kategoritë, përmbajtjen dhe shpeshësinë e llogaridhënies nga përfaqësuesit dhe organet, për të siguruar vënien vazhdimisht në dispozicion të informacionit të përditësuar dhe kuptimplotë, duke përfshirë informacionin për aktivitetin.
- 3.10 Organit të kontrollit duhet t'i jepen mjetet dhe autoriteti për të kryer detyrat e tij, duke përfshirë kohën e mjaftueshme për kontroll dhe kërkimin e sqarimeve, mundësinë për t'iu drejtuar njerëzve me shkallën e nevojshme të ekspertizës për t'i ndihmuar ata, dhe akses në informacionin dhe të dhënat përkatëse për të bërë një vlerësim të informuar. Kjo mund të përfshijë gjithashtu kompetencën për të kërkuar një auditim të jashtëm të pavarur në lidhje me çështje specifike që janë paraqitur (që synojnë) për t'u mbuluar.
- 3.11 Përkatësia politike nuk duhet të ndërhyjë në procesin e kontrollit që i paraprin një diskutimi ose votimi mbi konkluzionet përfundimtare. I njëjti informacion, brenda të njëjtave afate, duhet t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të organit të kontrollit, pavarësisht konsideratave politike. Rregullat duhet gjithashtu të garantojnë akses të drejtë të anëtarëve të grupeve politike në funksione specifike të kontrollit (për shembull, si relator ose anëtar i një grupi të veçantë kontrolli). Auditit periodik publik i detyrueshëm i autoriteteve lokale dhe rajonale duhet të organizohet në mënyrë të tillë që të sigurojë neutralitet politik.
- 3.12 Një përfaqësues ose organ, veprimi ose menaxhimi i të cilit është nën kontroll duhet të ketë mundësinë të dëgjohet dhe të japë shpjegime për veprimet dhe vendimet e tij.
- 3.13 Kur përfaqësuesit dhe organet mbahen përgjegjës për veprimet e tyre nga nivele të tjera të qeverisë ose organe të emëruara prej tyre në ndonjë nga rastet e mëposhtme, kjo duhet të përcaktohet qartë nga ligji: garantimi i respektimit të ligjit dhe parimeve kushtetuese; përshtatshmëria në lidhje me detyrat që u janë deleguar; një aktivitet i kërkuar ligjërisht i cili nuk është ndërmarrë; mbikëqyrja financiare që synon nxitjen e praktikave të mira kontabël dhe menaxhimin efektiv, parandalimin e disbalancave financiare ose monitorimin e rehabilitimit financiar të autoriteteve vendore që hasin vështirësi financiare.
- 3.14 Aty ku është me vend, mekanizmat për një përgjigje politike ndaj përfaqësuesve dhe organeve mund të përfshijnë: peticione që kërkojnë veprim për një çështje specifike; interpelanca që kërkon përgjigje; pyetje procedurale që kërkojnë përgjigje; një mocion besimi/mosbesimi nëse një person është i përshtatshëm për pozicionin e përgjegjësisë; një mocion censure ose pezullimi; shkarkim popullor me referendum.
- 3.15 Duhet të krijohen mënyra që punonjësit dhe palët e interesuara të zbulojnë dyshimet për shkelje, së bashku me masat mbrojtëse, duke u frymëzuar nga Rekomandimi CM/Rec(2014)7 për mbrojtjen e sinjalizuesve.
- 3.16 Të gjitha format e dhunës ndaj përfaqësuesve dhe kandidatëve duhet të dënohen qartë dhe, aty ku është e mundur, duhet të rezultojnë në sanksione. Nëse përfaqësuesit dhe organet (përfshirë të afërmit e tyre) mund të jenë në rrezik të dhunës fizike, gjuhës së urrejtjes, përfshirë urrejtjen seksiste, frikësimin dhe abuzimin në internet, shkatërrimin e pronës, etj., viktimat duhet të jenë në gjendje të përfitojnë nga mbrojtja e shpejtë dhe efektive, për shembull, me anë të urdhrave të mbrojtjes. Duhet të inkurajohet përdorimi i përgjegjshëm i rrjeteve sociale nga përfaqësuesit, organet dhe publiku në lidhje me politikën dhe çështjet publike lokale/rajonale.

iii. Pasojat

- 3.17 Procesi i raportimit dhe kërkesës për llogari, nëpërmjet kontrollit dhe mekanizmave të tjerë, do të nxjerrë në pah performancën e mirë dhe të dobët. Ai do të nxisë sjelljen e përgjegjshme dhe do të ndërtojë një kulturë të përgjegjshme të fokusuar në të mësuarit dhe zhvillimin e shërbimeve publike më të mira për të ardhmen.
- 3.18 Përdorimi i procedurave që synojnë përfundimin e parakohshëm të mandatit duhet të jetë i jashtëzakonshëm dhe i rregulluar në mënyrë rigoroze dhe të saktë me ligj. Legjislacioni duhet të përcaktojë garancitë procedurale të transparencës, legjitimitetit dhe ligjshmërisë së procesit të tërheqjes, të identifikojë qartë personat e përfshirë në proces dhe të përcaktojë pragjet për fillimin e procedurës dhe për vleftësimin e tërheqjes. Afatet kohore të qarta dhe të arsyeshme për nisjen e procedurës duhet të vendosen pas zgjedhjeve të mëparshme ose para zgjedhjeve të ardhshme, si dhe kontrolli juridiksional i hapave dhe kushteve të procesit.
- 3.19 Në veçanti:
- a. largimi popullor duhet vetëm të plotësojë mekanizmat e tjerë të disponueshëm në një demokraci përfaqësuese; ai duhet t'i nënshtrohet kufizimeve ligjore, për shembull në lidhje me kohën, numrin e nënshkrimeve që kërkohen, kuorumin për vendimet për largimin dhe shumicën e nevojshme për vendimet për largimin. Këto kufizime janë të rëndësishme për të shmangur transformimin e një mandati përfaqësues në një mandat imperativ;
 - b. largimi popullor duhet të jetë i mundur vetëm për ata që zgjidhen në funksionet e qeverisjes vendore dhe rajonale me votim të drejtpërdrejtë universal dhe të ndalohej për anëtarët individualë të këshillave të zgjedhur;
 - c. në parim, kuvendet lokale dhe rajonale nuk duhet të kenë autoritet për të shkarkuar kryetarët e bashkive dhe drejtuesit e tjerë të pushtetit vendor, të cilët zgjidhen drejtpërdrejt, përveçse kur shkarkimi është pasojë e pashmangshme e dorëheqjes kolektive të asamblesë ose rezulton në shpërndarjen e vetë asamblesë.
- 3.20 Masat administrative që sjellin pezullimin, largimin ose shkarkimin e qeverisjes vendore ose shpërbërjen e këshillave vendore me iniciativën e një niveli më të lartë territorial ose autoriteteve shtetërore duhet të jenë të jashtëzakonshme dhe të parashikohen qartë me ligj në një numër shumë të kufizuar rrethanash. Këto rrethana, të cilat duhet të përcaktohen me kritere të përcaktuara në ligj, duhet të përfshijnë rastin kur funksionimi i institucionit pengohet seriozisht dhe/ose kur mënyra e veprimit të tij nuk ndjek interesin publik të zgjedhësve vendorë/rajonale.
- 3.21 Përfundimi i parakohshëm i një mandati duhet të lejojë, nëse është e nevojshme, që zgjedhjet e reja të mbahen pa vonesë dhe të shmangë nevojën për të emëruar një drejtues kur rregullat ose situata nuk lejojnë një zëvendësues ose zëvendës të zgjedhur të kryejë funksionet e kërkuara.
- 3.22 Pasojat ligjore, civile, penale ose disiplinore të veprimeve ose mosveprimeve duhet të rregullohen me ligj, në mënyrë të qartë, të parashikueshme dhe të qëndrueshme, me masat mbrojtëse të përshtatshme për të parandaluar keqpërdorimin e tyre.
- 3.23 Në parim, përfaqësuesit nuk duhet të mbajnë përgjegjësi personale kur veprojnë brenda objektit të detyrave të tyre dhe në mirëbesim. Dispozitat e veçanta penale mund të parashikojnë situata në të cilat veprimi i përfaqësuesve sjell përgjegjësi në rastet e pakujdesisë së rëndë. Çështja e përgjegjësisë individuale të përfaqësuesve ose të organeve me personalitet juridik, duhet të vlerësohet nga një gjykatë e cila do të përcaktojë çdo sanksion të mundshëm të zbatueshëm. Mund të jetë e këshillueshme që të krijohen seksione të specializuara brenda gjykatave civile ose administrative për t'u marrë me çështjet e detyrimit financiar, ose organe të pavarura të specializuara për të dhënë opinione për çështje të tilla përpara se gjykatat të marrin vendimet.
- 3.24 Autoritetet lokale dhe rajonale duhet të lejohen të bëjnë sigurime që mbulojnë detyrimet e tyre financiare, dhe sigurim të përgjegjësisë monetare në emër të përfaqësuesve të tyre, për t'i mbrojtur ato nga paditë si rezultat i dëmit ose humbjes së pësuar nga qytetarët gjatë aktiviteteve normale të përfaqësuesit dhe organet të cilat janë kryer në interes të publikut dhe me kusht që dëmi ose humbja të mos vijë nga pakujdesia e rëndë ose me dashje. Autoritetet lokale dhe rajonale, ose përfaqësuesit e tyre të zgjedhur, duhet gjithashtu të lejohen të krijojnë organe të sigurimit të ndërsjellë për të mbuluar rreziqet e përmendura më sipër.

- 3.25 Në rastin e vendimeve të paligjshme të marra nga një organ kolegjal që vendos publikisht, këshillohet që të përjashtohet përgjegjësia personale e atyre që kanë justifikuar zyrtarisht kundërshtimin e tyre ndaj këtyre vendimeve, me kusht që të dihet se si ka votuar secili anëtar i organit kolegjal.
- 3.26 Zbatimi i çdo lloj mekanizmi automatik të sanksioneve monetare duhet të jetë i mundur vetëm pas një seance kundërshtuese, qoftë gjyqësore ose hapjes së të drejtës për proces gjyqësor, dhe konstatimit të pakujdesisë së rëndë ose dashjes.
- 3.27 Veprat penale të kryera nga përfaqësuesit gjatë kryerjes së detyrave të tyre duhet të tërheqin sanksione proporcionale dhe frenuese. Një masë shtesë e papërshtatshmërisë pas një dënimi duhet të jetë e kufizuar në kohë (jo e përhershme). Imuniteti nga ndjekja penale, përfshirë këtu kur gëzohet nga përfaqësues për shkak të një mandati shtesë të mbajtur në një nivel tjetër të qeverisjes, nuk duhet të pengojë ndjekjen penale në rastin e sjelljeve të rënda kriminale që përfshijnë interesat e autoritetit lokal ose rajonal.